



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2018:015742

Datë: 02.02.2024

Numri i dokumentit: 05277293

P.197/18

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - Dega në Kaçanik, Gjyqtari Burim Çaka, duke vendosur në çështjen penale kundër të pandehurit A.L, i akuzuar për veprën penale Vjedhje e pyllit nga neni 358 paragrafi 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj me numër PP/II.nr.738-5/18 të datës 18.04.2018, sipas detyrës zyrtare më datë 02.02.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

I. Hedhet aktakuza e Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr.738-5/18 të datës 18.04.2018, ndaj të pandehurit A.L, i akuzuar për veprën penale Vjedhje e pyllit nga neni 358 paragrafi 2 të KPRK-së, pushon procedura penale për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale sipas nenit 106 par 1 pika 1.5 lidhur me nenin 107 par 8 të KPRK-së.

II. Shpenzimet procedurale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Ferizaj ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.738-5/18 të datës 18.04.2018, ndaj të A.L për veprën penale Vjedhje e pyllit nga neni 358 paragrafi 2 të KPRK-së dhe ka kërkuar që të njëjtit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

Gjykata me rastin e analizimit të shkresave tjera të lëndës dhe erdhi në përfundim se në këtë rast kemi të bëjmë me parashkrim absolut të ndjekjes penale.

Për veprën penale Vjedhje e pyllit nga neni 358 paragrafi 2 të KPRK-së, është i paraparë parashkrimi relativ prej 3 viteve dhe dyfishi i asaj kohe paraqet parashkrim absolut nga ndjekja penale, ku në këtë rast nga kryerja e pretenduar e veprës sipas aktakuzës është shënuar se është kryer më datë 26.01.2018 ku deri në datën e marrjes së këtij vendimi kanë kaluar më tepër se 6 vite.

Për shpenzimet procedurale u vendos konform nenit 453 të KPPK-së

Nga të gjitha arsyet e cekura më lartë dhe konform nenit 106 par 1 pika 1.5 lidhur me nenin 107 par 8 të KPRK-së u vendos si në dispozitiv.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

P.nr197/18, datë 02.02.2024

Gjyqtari:

Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi, pala e pa kënaqur mund të ushtroj ankesë në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.